

LIGJ
Nr. 35/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR
BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK (OECD) PËR BËRJEN PALË NË
KUADRIN GJITHËPËRFSHIRËS TË PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR MBI
EROZIONIN E BAZËS SË TATUESHME DHE TRANSFERIMIN E FITIMIT
(BEPS)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS), sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS) do të paguhet një kuotë anëtarësie prej 20 200 (njëzet mijë e dyqind) eurosh në vit, vlerë e cila do të rregullohet dhe me inflacionin vjetor përkatës, të përcaktuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.6.2019.

**Shpallur me dekretin nr. 11217 , datë 4.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

Drejtori
QENDRA PËR POLITIKË TATIMORE
DHE ADMINISTRIM

Shkëlqesisë së Tij z. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Shqipëri

I nderuar Ministër,

Dëshiroj t'iu shkruaj në vijim të letrës që iu është dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i OECD-së më 24 maj 2016 me anë të së cilës Shqipëria ftohet që t'i bashkohet Kuadrit Gjithëpërfshirës për zbatimin e Projektit OECD/G20 BEPS (bashkëlidhur). Duke iu bashkuar këtij projekti, Shqipëria do të punojë në mënyrë të barabartë me 113 vende dhe juridiksione të tjera për të zbatuar Paketën e Plotë BEPS të realizuar në tetor 2015 dhe për të zhvilluar standardet për çështjet e mbetura të BEPS-it. Projekti BEPS pritet të zgjasë deri më dhjetor 2020.

Për t'u asociuar në Projektin BEPS, Shqipëria duhet të angazhohet në Paketën e Plotë BEPS, duke përfshirë katër standardet e saj minimale dhe zbatimin e saj të qëndrueshëm, duke theksuar se koha e zbatimit mund të variojë për të reflektuar nivelin e zhvillimit të vendeve dhe juridiksioneve.

Gjithashtu, pritet që Shqipëria të kontribuojë në mënyrë aktive në Projekt, duke përfshirë dialogun e politikave dhe shkëmbimin e informacionit. Afatet dhe modalitetet e pjesëmarrjes së Shqipërisë do të zbatohen sipas rregullave të përgjithshme që aplikohen për pjesëmarrjen në takimet e Kuadrit Përfshirës. Në fund, Shqipëria do të kontribuojë për shpenzimet që lidhen me realizimin e Projektit BEPS me anë të një tarife vjetore prej 20,200 EURO. Kjo shumë do t'i nënshtrohet ndryshimeve vjetore për shkak të inflacionit.

Nëse asocioheni te BEPS-sa do të thotë se Shqipëria do të marrë pjesë në një gamë të plotë punësh të kryera në BEPS-ja, nga Kuadri Përfshirës dhe organet e tij vartëse në mënyrë të barabartë me anëtarët e OECD-së, i cili përfshin:

- ftesën në të gjitha mbledhjet e agjendës së Kuadrit Përfshirës dhe organeve të tij vartëse që lidhen me BEPS;
- pjesëmarrjen në të gjitha vendimarrjet për të gjitha rezultatet që lidhen me Projektin BEPS dhe që shoqërohen me këto rezultate, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe;
- delegatët e saj kanë të drejtë të zgjidhen në Grupin Drejtues të Projektit BEPS.

Kjo letër dhe përgjigja pozitive e Shqipërisë do të përbëjnë pranimin nga Shqipëria të kësaj ftese dhe të kushteve e afateve të lartpërmendura. Në përputhje me kërkesën tuaj, pranimi i Shqipërisë do të hyjë në fuqi sapo Shqipëria të kryejë njoftimin me anë të kanaleve diplomatike se janë përmbushur të gjitha kriteret ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Ju lutemi gjeni bashkëlidhur modelin e letrës së përgjigjes drejtuar ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm për Shqipërinë për t'iu bashkuar Projektit BEPS si vend i asociuar.

Ju inkurajoj që të dërgoni përgjigjen tuaj për këtë ftesë zyrtare sa më shpejt që të jetë e mundur (CTP.BEPS@oecd.org) për të siguruar se Shqipëria do të mund të marrë pjesë në takimin e ardhshëm plenar të Kuadrit Përfshirës, i cili do të zhvillohet më 27–28 qershor 2018 në Lima, Peru.

Mbetemi në pritje të mbështetjes dhe angazhimit tuaj ndaj Projektit BEPS dhe pjesëmarrjes aktive të Shqipërisë si anëtare e Kuadrit Gjithëpërfshirës.

Me respekt,
(nënshkrimi)

Pascal Saint-Amans
Drejtor, CTPA

2, rue André-Pascal
75775 Paris Cedex 16, France

www.oecd.org/ctp
pascal.saint-amans@oecd.org

Linja e drejtpërdrejtë
Tel.: +33 (0) 1 45 24 91 08

**PËRGJIGJE SHKRESËS SË OECD-SË TË DATËS 27 MARS 2018 PËR BËRJEN
PALË NË PROJEKTIN BEPS**

Datë, _____2019, Tiranë, Shqipëri

I nderuar Sekretar i Përgjithshëm,

Kam nderin të konfirmoj marrjen e shkresës suaj të datës 27 mars 2018, me anë të së cilës Shqipëria ftohet për të marrë pjesë në Projektin BEPS si partnere e asociuar për kohëzgjatjen e Projektit.

Kam nderin t'iu informoj se shkresa juaj dhe kjo përgjigje përbëjnë pranimin nga Shqipëria të ftesës suaj dhe të termave dhe kushteve të përcaktuara në të, duke theksuar se kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Shqipëria, me rrugë diplomatike, se të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar.

Me pranimin e ftesës suaj, Shqipëria i bashkohet Anëtarëve të Projektit BEPS në angazhimin e tyre ndaj paketës gjithëpërfshirëse BEPS dhe zbatimit të saj të qëndrueshëm, duke theksuar se afati i zbatimit mund të ndryshojë për të pasqyruar nivelin e zhvillimit të vendeve dhe juridiksioneve.

Me respekt,

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Anila Denaj